ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 387117
Datë/Datum 16.10.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Një ankesë kundër: **(MINISTRIA E INFRASTRUKTURES)**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**205-17-2437-5-1-1**
Nr i Brendshëm	**MI 17 041 511**

Sa i përket tenderit për **(Zgjerimi i Rrugës Nacionale N25,segmenti rreth-rrotullimi Besi – Podujevë, Loti4, st.11+740.00 deri ne st.16+000.00 (nga p688 deri P929), L=4,260.00m) .**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i OE-ve "Alko-Impex GC Shpk & Exfis Shpk & 2T Shpk".
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Ndue Perlleshi, Kompleksi "Alko-Impex" Mati 1.
(Adresa)

Prishtine — *(Vendi)*
10000 — *(Kodi postar)*

045 / [redacted] — *(Numri Telefonit)*
(Numri i Faks-it)

Imer Ademi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[redacted]@gmail.com
(Adresa elektronike)

General Construction Co. ALKO IMPEX

16.10.2017
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës];

Njoftimi per Kontrate dt. 30.05.2017 .
Procedure e hapur me vlere te madhe.
Afati per dorezimin e tendereve dt 17.07.2017 ora:14:00.
Me date 26.09.2017 kemi pranuar Letren Standarte per Tenderuesin e eleminuar.
Kriter per dhenien e kontrates eshte Çmimi më i ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] Jo [ ]

Procesi i hapjes se ofertave eshte bere me date 17.07.2017 ne ora 14:30 dhe ka shkuar normalisht

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Me date 02.10.2017 kemi dorezuar kerkesen per rishqyrtim prane AK-es, dhe me date 06.10.2017 kemi pranuar vendimin per rishqyrtim me te cilin na eshte refuzuar kerkesa per rishqyrtim. Bashkangjitur gjeni kopjen e kerkeses per rishqyrtim dhe vendimin e AK-es.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojme se Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me Ligjin Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 :

- **Neni 1 ,** Qëllimi
- **Neni 6 ,** Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- **Neni 7 ,** Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- **Neni 41 ,** Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës
- **Neni 56 ,** Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- **Neni 59 ,** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- **Neni 60 ,** Kriteret për Dhënien e Kontratës
- **Neni 66 ,** Përshtatshmëria Profesionale
- **Neni 68 ,** Gjendja Ekonomike dhe Financiare
- **Neni 71 ,** Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne baze te raportit te vleresimit kemi konstatuar se ne jemi eleminuar nga ky aktivitet prokurimi per arsyet e meposhtme:

1. **<u>Alko-Impex, auditimet per vitin 2013dhe 2014 jo kompani e licencuar.</u>**

Per kete aktivitet ne kemi ofertuar si Grup i Operatoreve Ekonomik dhe jo individualisht prandaj deklarojme me pergjegjesi te plote se ne dosje te tenderit ne kemi te bashkangjitur raportet e auditimit konform kerkeses se dosjes se tenderit. Ju lutemi qe ju si Organ Shqyrtues i Prokurimi te kontrolloni edhe njeher ne dosje te tenderit dhe do te gjeni raportet e audituara nga nje kompani e licencuar (ashtu siq kerkohet ne FDT), te kompanise Exfis Shpk. Neni 71 i LPP-se dhe Neni 27.3 tek RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK e percakton shume qarte se cdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-se **do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit**. Prandaj kerkesa ne lidhje me auditimet eshte kerkese qe hyn tek kerkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare konfom Nenit 68 te LPP-se dhe aplikohet ndaj grupit ne teresi dhe jo ndaj anetareve individual.

2. **<u>Anetari i konzorciumit "Exfis" nuk e ka veprimtarine per rruge te regjistruar ne certifikate te biznesit.</u>**

Ne baze te kerkesave ne dosje te tenderit dhe ne FDT askund nuk eshte kerkuar qe OE-të duhet te kene veprimtarine per rruge ne qertifikaten e biznesit. Ne FDT tek kerkesat e pershtatshmerise profesionale eshte kerkuar siq citoj: *"Regjistrimi i OE në regjistrin profesional,komercial ose korporatës në vendin e themelimit e përkthyer në gj.shqipe,angleze ose serbe.(Ofertuesi jo rezident sipas Ligjit aktual të Kosovë LPP Nr 04/L-042) është i detyruar të paraqes çertifikatën e regjistrimit të njësisë përhershme-para kopje të noterizuar."*, ndersa si deshmi eshte kerkuar: *"Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik e të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit)"*, dhe te gjithe anetaret e konzorciumit kemi paraqitur te gjitha deshmite konform kerkeses se dosjes se tenderit. Pra nese nje kerkese e tille do te ishte ne FDT kjo kerkese ka te beje me Nenin 66.2 te LPP-se dhe perseri edhe kjo kerkese ploteschen nga dy anetaret e tjere te grupit (Alko-Impex Shpk & 2T Shpk), ashtu siq e parasheh Neni 71 i LPP-se dhe Neni 27.3 tek RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK i cili e percakton shume qarte se cdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve **<u>66.2,</u> 68 dhe 69 të LPP-se do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.**